



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.5., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 07.07.2023, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. Dop. Dep.	Nr. Prot. St. Prot. Prot. No.
06/02	1368/23
Nr. Faq. Br. Str. Nr. Faqe.	Data Datum Dat.
02	07-07-2023

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-720/23, për z. Isuf Hajdaraj, ish-zyrtar për Mbrojtjen e Mjedisit në Drejtorinë për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë të Komunës së Suharekës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

## A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për ish-zyrtarin z. Isuf Hajdaraj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ka pranuar informatën nga raportuesi i jashtëm (DPKI/06-720/23), me “*kërkesën për interpretim lidhur me situatë të mundshme të konfliktit të interesit në rastin e z. Hajdaraj, i cili si zyrtar i Komunës ka marrë pjesë në përgatitjen e Hartës Zonale të Komunës së Suharekës, dhe njëkohësisht është edhe përfaqësues i autorizuar në biznesin “Niti Construction DGGL” të cilit biznes me aktvendim të Komunës i është dhënë leje ndërtimore për ndërtim të objektit afaristo-banesor në Suharekë, pastaj i njëjti është anëtar i subjekti politik AAK dhe merr tenderë publike me kompaninë në fjalë.*”

Andaj, konform mandatit dhe kompetencave ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, respektivisht nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., Agjencia ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimin për konflikt të interesit nëse z. Hajdaraj ka marrë pjesë në vendimmarrje me rastin e marrjes së lejes ndërtimore për kompaninë në fjalë, apo të ndonjë tenderi/kontrate nga Komuna e Suharekës, dhe atë në kuptim dispozitive të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit që kanë të bëjnë me vendimmarrjen për interes privat.

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitive të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-843/23).



Gjatë trajtimit të rastit, Agjencia ka pranuar informacionin se Komuna e Suharekës me Aktvendimin 01-Nr-118-21296 të datës 31.03.2023, e ka ndërprerë marrëdhënien e punës për z. Isuf Hajdaraj, dhe atë sipas kërkesës së këtij të fundit.

Megjithatë, me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike sipas pretendimeve të raportuesit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga Komuna e Suharekës, informacione relevante përkitazi me pjesëmarrjen eventuale të z. Hajdaraj, në ndonjë fazë vendimmarrëse për interes privat.

Sipas informatave nga Komuna e Suharekës (DPKI-06-376-2/23), z. Hajdaraj nuk ka marrë pjesë në procesin e lëshimit të lejeve ndërtimore sepse nuk ka punuar në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim, e as nuk është gjetur që Zyra e Prokurimit të ketë lidhur ndonjë kontratë me kompaninë "Niti Construction DGGL", në shtatë vitet e fundit, andaj Agjencia nuk ka gjetur se ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit në frymën e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Pretendimi në fjalë për konflikt të interesit, është trajtuar nga këndvështrimi i përfitimit eventual personal duke qenë pjesëmarrës në vendimmarrje, e që lidhet me "konfliktin e interesit", respektivisht, sipas nenit 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se "Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare", si dhe "vendimmarrjen" e cila sipas nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, përcaktohet si çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj, nga sa u tha më lartë, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshka  
Drejtor i Agjencisë për  
Parandalimin e Korrupsionit

